



Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE

EC MA NDRYSHE PLANI I PUNËS 2022

Rr. Fehmi Lladrovci 94, 20000/Prizren ~ Bulevardi Nënë Tereza H30 B1 Nr. 5, 10000/Prishtinë
www.ecmandryshe.org ~ info@ecmandryshe.org ~ 038-224-967 & 029-222-771

Hyrje / Kontekst

EC beson në nevojën dhe domosdoshmërinë e organizimit komunitar si garancën më të madhe të demokratizimit dhe zhvillimit. Trekëndëshi konceptual që orientonë punën e organizatës përbëhet nga këto elemente mjaft të rëndësishme: 1. Gjithëpërfshirjen, 2. Qëndrueshmërinë, dhe 3. Dijen. EC beson në bashkëpunim të njëmendtë me të gjithë, nga individët e vullnetit të mirë te institucionet publike, gazetarët, banoët e lagjes, donatorët, dhe shumë grupe të tjera të shoqërisë. Vetëm të koordinuar në veprime mund të ofrojmë më të mirën tonë brenda përpjekjeve të përbashkëta për një Kosovë të përparuar në kuptimin demokratik dhe zhvillimor.

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikqyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore. Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshtëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga posht lart.

Qëllimet strategjike dhe Programet

Plani Strategjik i EC është i ndërtuar mbi tri qëllime strategjike të cilat brenda vetes kanë objektiva strategjike që përshkruajnë në detaje më të mëdha se si do të përmbush dhe të arrijë EC misionin dhe vizionin e saj, respektivisht:

- *Qëllimi Strategjik 1 – Komunitete lokale të mirorganizuara dhe presioni i rritur publik nxisin praktika të përparuara të qeverisjes demokratike dhe gjithëpërfshirëse në komunat e Kosovës. Konkretisht synojmë:*
 - Objektiva Strategjike 1.1 - Praktika të mira të konsultimit dhe përfshirjes publike në vendimmarrjen komunale.
 - Objektiva Strategjike 1.2 - Grupe të komunitetit, organizata dhe media lokale të fuqizuara që sigurojnë mbikqyrje efektive të vendimmarrjes.
 - Objektiva Strategjike 1.3 - Angazhim direkt të qytetarëve në mbrojtjen dhe përcaktimin e hapësirave publike.
 - Objektiva Strategjike 1.4 - Mbrojtje efektive të strukturës urbane dhe zonave historike të qyteteve të Kosovës.
- *Qëllimi Strategjik 2 – Dimensionet mjedisore dhe sociale të integruara në programe dhe politika që synojnë zhvillim të balancuar dhe të qëndrueshëm lokal dhe rajonal. Konkretisht synojmë:*
 - Objektiva Strategjike 2.1 – Vendimmarrja komunale që ndjek parimet e QZHQ (SDG) sa herë që planifikon dhe zbaton politika dhe programe zhvillimore.
 - Objektiva Strategjike 2.2 – Mbrojtje efektive të mjedisit, rritje të efijencës energjetike, shtim të zonave të gjelbra dhe konsum të reduktuar në zonat urbane.
 - Objektiva Strategjike 2.3. – Edukimin mjedisor të gjeneratave të reja duke e përfshirë aktivizimin mjedisor në programin e shkollave fillore dhe të mesme.

- Objektiva Strategjike 2.4 – Edukimin mjedisor të gjeneratave të reja duke e përfshirë aktivizmin mjedisor në programin e shkollave fillore dhe të mesme.

Qëllimi Strategjik 3 – Vëllim i rritur i dijes sektoriale për të ushqyer debatin shoqëror dhe politikëbërjen, si dhe një organizatë me shkathtësi të konsoliduara programore dhe qëndrueshmëri institucionale.
Konkretisht synojmë:

- Objektiva Strategjike 3.1 – Vëllim të rritur të dijes profesionale në shërbim të aktivizmit, avokimit dhe nxitjes së debatit publik.
- Objektiva Strategjike 3.2 – Ofrim të shërbimeve profesionale për palët e treta si mundësi për të konsoliduar qëndrueshmërinë financiare.
- Objektiva Strategjike 3.3 – Ofrim të shërbimeve profesionale për palët e treta si mundësi për të konsoliduar qëndrueshmërinë financiare.

Procesi i planifikimit strategjik ka rishikuar edhe qasjen programore të organizatës. Duke filluar nga shkurti i vitit 2020, EC funksionon me këto tri programe:

1. GJITHËPËRFSHIRJE (Qytete / Komuna Gjithëpërfshirëse)

Programi i Gjithëpërfshirjes është vazhdimësi e veprimeve tashmë të njohura të organizatës, por me në thellësi më të madhe profesionale dhe konceptuale. EC tani trajton angazhimin qytetar dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje përtej nivelit utilitar politik. Qyteti, fshati apo çfarëdo hapësire tjetër (lokalitet banimi dhe jetese) është mbi të gjitha një e drejtë themelore dhe e pamohueshme e banorëve. Programi do të fokusohet në zhvillimin e grupeve ekzistuese si dhe në formimin e grupeve të reja të komunitetit në nivele të ndryshme të komunave.

2. QËNDRUESHMËRI (Zhvillim i Qëndrueshëm)

Fokusi i programit parasegjithash do të jetë në sfidat mjedisore. Zonat urbane dhe zonat e mbrojtura të natyrës janë më të rrezikuara dhe veprimet e EC do të shtrihen me prioritet në këto hapësira. Për të siguruar vendimmarrje të përgjegjshme komunale, organizata do të avokojë për përkthimin e QZHQ (SDG) në mendësinë dhe praktikën e zhvillimit dhe zbatimit të politikave publike. Nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme do të trajtohen si grup me rëndësi të veçantë për të krijuar gjeneratën e së ardhmes që aktivizmin mjedisor e kupton si përgjegjësi sociale. Në mënyrë të veçantë, EC do të krijojë partneritete vepruese me institucionet publike në zbatimin e programeve zhvillimore përmes shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve kulturore dhe natyrore të Kosovës.

3. DIJE (prodhim i dijes)

EC ka publikuar dhjetëra raporte dhe analiza, rezultat i punës hulumtuese. Dija e prodhuar do të vazhdojë të përdoret për të fuqizuar argumentin avokues. Produktet e hulumtimit do të synojnë temat që mbulohen nga dy programet e para të organizatës. Pjesë e programit të dijes janë edhe shërbimet profesionale, të cilat synojnë të konsolidojnë bazën e qëndrueshmërisë financiare të organizatës. Në të njëjtën kohë, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet zhvillimit të mëtejshëm dhe të përhershëm të kapaciteteve të brendshme organizative, profesionale dhe vepruese.

Metodat e punës

EC përdor metodologji të kombinuar të punës. Ndonëse organizatë me bazë në komunitet, EC në vazhdimësi ka konsoliduar kapacitetet hulumtuese dhe analitike. Ndër komponentët më të fuqishëm të organizatës mbeten fokusi ndaj rrjetëzimit të brendshëm (brenda shoqërisë civile) dhe dialogut të politikave me komunat për reformat e domosdoshme. Në vijim, metodat e punës së EC:

Mobilizimi i komunitetit – EC është në komunikim të përhershëm me grupet e komunitetit dhe përmes nismave synon t'i mobilizojë këto grupe rreth çështjeve të rëndësishme të qeverisjes dhe zhvillimit lokal,

Monitorimi i komunave – një përpjekje e vazhdueshme që nuk kufizohet vetëm në organet komunale, por prek edhe gjyqësinë, policinë, qeverinë qendrore, etj. Monitorimi gjeneron informacion të bazuar dhe forcon aktivitetin avokuese të organizatës,

Avokimi për ndryshim – një numër mjetesh përdoren për të ushtruar presion të drejtpërdrejtë ndaj komunave dhe dhe institucioneve tjera shtetërore. Veprimet avokuese të EC synojnë ndryshimin në sferat e transparencës dhe llogaridhënies dhe politikave të zhvillimit të qëndrueshëm,

Dialogu i politikave – organizata është pjesë e një numri procesesh të dialogut të strukturuar me institucione publike. Dialogu për politika publike ka forma të ndryshme dhe synon rritjen e komunikimit mes qytetarëve dhe institucioneve të shtetit për zbatim efektiv të politikave,

Rrjetëzimi – Përmes Rrjetit të Organizatave të Kulturës, Forumit Transparenca, Iniciativës për Mbrojtjen e Kino Lumbardhit dhe veprimeve të ngjashme, EC ka dëshmuar se rrjetëzimi është mjef efektiv i avokimit dhe ndryshimit, dhe për këtë arsye vazhdon të jetë një nga metodat më të rëndësishme të punës së organizatës,

Hulumtimi – EC ka prodhuar një numër të konsiderueshëm dokumentesh të hulumtimit. Gjatë viteve të fundit, organizata ka investuar rregullisht në ngritjen e cilësisë së hulumtimit, ndërsa prej vitit 2015 ka hulumtimin (prodhimin e dijes) si njërin nga tre programet e organizatës. Për të konsoliduar këtë kapacitet, EC ka përgatitur një plan të veçantë që do të udhëzojë zhvillimin e kapaciteteve hulumtuese të organizatës.

Projektet dhe iniciativat

Projektet dhe iniciativat kryesore të organizatës në kuadër të tri programeve të saj për vitin 2022, do të jenë por nuk do të kufizohen:

1. **Qytete gjithëpërfshirëse 2022** - Projekti do të jetë vazhdimësi e metodologjisë së re të projektit, ku nga puna me grupet e komunitetit (me bazë identitare) u kalua në organizimin e njëjësive komunitare në nivel të lagjeve të qytetit dhe në disa fshatra si dhe në disa qytete tjera. Projekti synon përkthimin e nevojave dhe kërkesave të qytetarëve në plane të zbatueshme urbane. Aktivitetet që do të realizohen gjatë vitit janë: takimet e rregullta në lagje, punëtoritë e vizionimit, performansat publike, hulumtimi, aktivizimi ndaj autoriteteve publike, zhvillimi dhe konsolidimi i platformës online mahalla.info, monitorimi i qeverisë lokale, fushata mediale, dokumentimi dhe ekspozita me konferencën vjetore.
2. **“Aktivizimi për të drejtat e njeriut 2020-2023** - Projekti ka për qëllim që nëpërmjet shoqërisë civile të përmirësoj të drejtat e njeriut, që janë të natyrshme, origjinale dhe të bazuara në interes të grupit përmes tri komponenteve: 1) Të drejtat e njeriut dhe aktivizimi arsimor; 2) Dokumentimi, monitorimi dhe qasja strategjike dhe 3) Të drejtat mjedisore. Në kuadër të projektit janë realizuar dhe do të realizohen: takime me grupe të ndryshme të komuniteteve dhe përfaqësues të institucioneve, intervenime direkte në hapësira publike për të rritur sasinë e sipërfaqes gjelbëruese, për të krijuar qasje më të lehtë për personat me nevoja të veçanta, trajnime me nxënës dhe studentë, zhvillim të raporteve, hulumtimeve, prodhim të video reportazheve, animacioneve, organizim të debateve/konferencave, performanca publike etj. Projekti realizohet në Prizren dhe Gjakovë por me angazhimin dhe vullnetin e stafit shumë aktivitete janë realizuar edhe në qytete tjera (Dragash, Suharekë, Mamushë, Malishevë, Rahovec, Deçan, Pejë, Ferizaj, Gjilan, Kamenicë, Kacanik, Viti, Lipjan, Mitrovicë). Projekti do të implementohet edhe gjatë vitit 2022 dhe 2023.
3. **Zbatimi i programeve të strategjisë të EC**
Projekti është grant institucional i cili ka për qëllim zbatimin e programeve të EC dhe vazhdimin e përpjekjeve të organizatës për gjithëpërfshirje dhe qëndrueshmëri me fokus te qytetari si garantuesi kryesor i demokracisë dhe zhvillimit. Gjatë periudhës raportuese e deri në përfundim të grantit EC ka vazhduar të zbatojë dhe të realizoj aktivitete që i shërbejnë objektivave strategjike të organizatës. Në kuadër të aktiviteteve të realizuara hyjnë publikimet, takimet, anketat, infografikat, prodhimi i videove të shkurta që trajtojnë tematika dhe probleme të ndryshme, video/reportazhe televizive, artikuj gazetaresk, debate/tryeza diskutimi, reagime/komunikata, monitorim i institucioneve, aksione pastrimi etj. Këto aktivitete jo vetëm kanë sjellë rezultate por kanë shërbyer edhe për promovim dhe nxitje të debatit.
4. **“Dollama, një pasuri kulturore e Kosovës” (2021 – 2022)** - Projekti “Dollama, një pasuri kulturore e Kosovës” është vazhdimësi e përpjekjeve të EC Ma Ndryshe në mbrojtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore. Projekti ka për qëllim që të kontribojë në ruajtjen e zanatit të punimit të dollamave përmes promovimit dhe transferimit të njohurive. Projekti përfshin rajonin e Prizrenit dhe aktivitetet do të përfshijnë përfaqësues të të gjitha komuniteteve të këtij rajoni. Pjesëmarrëset nga komuna e Prizrenit, Dragashit, Suharekës (Theranda), Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës do të mësojnë zejen tradicionale të punimit të „dollamave“ nga profesionistë më përvojë të gjërë në këtë fushë.

5. **Hulumtimit të Turizmit Rural në Rajonin Jugor të Kosovës (2021 – 2022)** - Qëllimi i këtij projekti është të kontribuojë në hartëzimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore përmes dokumentimit, promovimit, transferimit të njohurive dhe aftësive tek të rinjtë dhe komunitetet me përkatësi të ndryshme etnike nga Rajoni Ekonomik Jugor i Kosovës (gjashtë komunat: Prizren, Rahovec, Mamushë, Dragash, Suharekë, Malishevë). Projekti gjithashtu synon të shërbejë në ngritjen e ndërgjegjësimit të institucioneve vendore dhe qendrore për konceptin “ende të pazhvilluar dhe plotësisht të eksploruar” të turizmit rural si një faktor i qëndrueshëm që ofron edukim dhe zhvillim të qëndrueshëm të komuniteteve lokale.

Iniciativat tjera

1. **MODERNe** - Iniciativa për Vlerësimin, Mbrojtjen dhe Promovimin e Trashëgimisë Moderne në Kosovë, është nismë me bazë në grup profesionistësh dhe përfaqësues të komunitetit me qëllim të vlerësimit, mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë moderne në qendrat kryesore të Kosovës. Qëllimi i iniciativës është nxitja e debatit publik mbi vlerat e trashëgimisë së shekullit XX dhe zhvillimeve sociale, kulturore e ekonomike që përcollën fillet dhe zhvillimin e arkitekturës dhe artit modern në Kosovë. MODERNe synon që përmes hulumtimit, dokumentimit dhe kultivimit të diskutimit publik mbi vlerat e trashëgimisë moderne të arrijë të kontribuojë në mbrojtjen dhe promovimin kësaj pjese të rëndësishme të trashëgimisë tonë.
2. **Politikat kulturore lokale (RrOK Prizren)** – rrjetëzimi lokal i skenës së pavarur kulturore është ndër zhvillimet më të rëndësishme në sektorin e kulturës në Prizren. Si pjesë e këtij rrjeti, EC do të vazhdojë të angazhohet për zhvillimin e politikave kulturore lokale në Prizren, që do të sigurojnë zbatim konkret të zotimeve për zhvillim ekonomik përmes kulturës të vendosura në Planin Zhvillimor Komunal 2025 të Prizrenit.
3. **Rrjeti i Organizatave Rinore në Prizren (RrOR)** - EC-i do të vazhdojë të jetë pjesë e këtij rrjeti me qëllim që të kontribuojë duke shpërndarë metodologjinë gjithëpërfshirëse dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së të rinjëve në planifikim dhe në vendimmarrje të politikave për zhvillim lokal dhe duke ngritur kapacitetet e organizatave më të vogla.
4. **Kino Lumbardhi** – iniciativa për mbrojtjen e kinos ka ofruar një shembull të mirë se organizimi dhe bashkimi mund të sjellë efekte të dëshiruara. Angazhimi për Kino Lumbardhin do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2022, me synimin që të përfundojë procesi i shpronësimit nga qeveria e Kosovës te Komuna e Prizrenit.
5. **Rrjetëzimet** – EC do të vazhdojë të konsolidojë pozitën e vet brenda rrjeteve nacionale dhe rajonale, ndërsa si pjesë e tyre do të vazhdojë të jetë pjesë e iniciativave të shoqërisë civile në nivelin qendror. Këto iniciativa përfshijnë: zbatimin e strategjisë së bashkëpunimit mes qeverisë dhe shoqërisë civile (përmes Civikos), hartimin e strategjive shtetërore të kulturës dhe trashëgimisë kulturore (përmes Forumit Kulturor) hartimin e strategjive shtetërore për komuanet e Kosovës dhe hartimin e strategjive shtetërore të ambientit në bashkëpunim me ministritë relevante etj.

6. **E drejta mbi qytetin** - Avancimi i Kartës së Qytetit në nivel praktik, pas hartimit të tij në një proces gjithëpërfshirës dhe miratimit nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit. Promovimi i modelit edhe në komunat e tjera të Kosovës dhe bashkëpunimi mes komunave për të zhvilluar konceptin e të drejtës mbi qytetin.

Plani i punës për vitin 2022 u miratua në takimin vjetor të Kuvendit të Anëtarëve të EC Ma Ndryshe, mbajtur më 4 Qershor 2022, në Prizren.



Në emër të Kuvendit të Anëtarëve
Flaka Siqeca, kryesuese e Kuvendit të Anëtarëve



Në emer te startit te organizatës
Valon Xhabali, drejtor ekzekutiv